




**BASHKIA
TIRANË**



TË MËSOJMË PËR TË ARDHMEN TONË

Material mbështetës për edukimin dhe këshillimin
për karrierën për nxënësit e **shkollave të mesme**




Ky material është në mbështetje të edukimit dhe këshillimit për karrierën për nxënësit në arsimin parauniversitar dhe ofrohet për shkollat e përzgjedhura në Tiranë për pilotim në vitin shkollor 2022-2023 sipas marrëveshjes ndërmjet **Ministrit të Arsimit dhe Sportit** dhe **Bashkisë së Tiranës**, lidhur më datë **05.05.2022**. Materiali është menduar për përdorim në orët e kujdestarisë nga mësuesit kujdestarë, psikologët, punonjësit socialë në shkolla ose punonjësit e këshillimit të karrierës në Bashkinë e Tiranës.

Këto veprimtari janë pjesë e një programi më të gjerë për zhvillimin e edukimit dhe këshillimit të karrierës në Shqipëri dhe mbështeten nga:

Mbështetur nga:



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Materialet u përgatitën nga

Astrit Dautaj, Përgjegjësi i Kurrikulës në ASCAP
Sokol Avxhiu, Ekspert/Këshillues për Karrierën

Hyrje

Moduli “**Të mësojmë më shumë për veten dhe profesionet**” për nxënësit e arsimit të mesëm synon, *në radhë të parë*, të mbajë nxënësit e kësaj moshe të përfshirë në një **proces reflektimi për zgjedhje dhe vendime** të mirinformuara për jetën e tyre në të gjitha fushat e veprimtarisë.

Së dyti, nxënësit, tashmë në moshën e vendimmarrjes për të ardhmen, ftohen të reflektojnë për njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të kryer punët dhe shërbimet, me të cilat lidhen profesionet e ndryshme, orientohen të fillojnë të mendojnë për karrierën e tyre të ardhshme, për rëndësinë që ka shkolla për pajisjen e tyre me njohuritë dhe aftësitë që kërkojnë profesionet që ata dëshirojnë të ushtrojnë në të ardhmen, si dhe të fillojnë të planifikojnë hapat për të hedhur themelet për të ardhmen e tyre.

Së treti, nxënësit nxiten të mendojnë për rëndësinë e të mësuarit të vazhdueshëm dhe në të gjitha lëndët, për të mbajtur gjallë të gjitha mundësitë për zgjedhjen e profesionit që dëshirojnë, në përfundim të arsimit të mesëm të lartë. Edhe në këtë fazë të shkollimit, boshti i procesit të reflektimit të nxënësit për karrierën e tij të mundshme, mbetet **pajisja e tij me kompetencat për jetën**, për të nxënësit gjatë gjithë jetës dhe me aftësinë për të marrë vendime të mirinformuara.

Në këtë këndvështrim, *së katërti*, ky modul synon të ftojë nxënësin të kuptojë rëndësinë e të menduarit për të ardhmen, rëndësinë e planifikimit të kësaj të ardhmeje dhe hedhjes së themeleve të saj që në bankat e shkollës. Moduli synon të krijojë e të konsolidojë te nxënësit modelin e vendimmarrjes së mirëmenduar për jetën. Marrja e vendimit duhet të bëhet gjithnjë përmes një procesi që synon mbledhjen e informacionit të plotë për çështjen, për të cilën do të merret vendimi, duke ruajtur dyshimin si parim metodologjik, përmes të mësuarit nëpërmjet hulumtimit, përmes kërkimit dhe identifikimit të burimeve të sigurta të informimit, duke qenë i orientuar nga e ardhmja, duke mbajtur parasysh lidhjen shkak-pasojë etj.

Pandemia dhe të mësuarit online na tregoi që nuk mund të planifikojmë gjithmonë jetën tonë; që do të përballemi gjithmonë me situata të papritura në jetë e në shkollë; që situatat e reja na gjejnë të papërgatitur për t'u përballur me to; që të parapërgatiturit e patën më të lehtë përballjen me situatën e re.

Pra, e vetmja gjë që mund të bëjmë është të përgatitemi për të papriturat. Rruga e vetme për këtë qëllim është pajisja me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për jetën, me modelet e të menduarit dhe të të zgjidhurit të problemeve. Në këtë kuptim, e ardhmja varet nga e sotmja, nga përkushtimi ynë për të mësuar vazhdimisht dhe në të gjitha fushat. Asnjëherë nuk e dimë çfarë na vë përpara jeta.

Në këtë kuptim, ky modul do të ndihmojë nxënësit të bëjnë zgjedhjet më të mira për veten, kurdo qoftë koha për të marrë këto vendime..

Si dhe ku duhet të zhvillohet moduli?

Moduli përmban disa veprimtari të lidhura në mënyrë logjike me njëra-tjetrën, duke ruajtur në të njëjtën kohë edhe pavarësinë e tyre.

Moduli mund të zhvillohet në **7-9 orë mësimore**. Megjithatë, ai mund të shtrihet edhe më gjatë, në varësi të kërkesave ose të veçorive të mjedisit shkollor.

Në varësi të hapësirave që krijohen në kohë të ndryshme, mund të zhvillohen edhe veprimtaritë që janë pjesë e tyre, nëse një nevojë e tillë lind gjatë kryerjes së veprimtarive mësimore, të veprimtarive jashtëkurrikulare ose jashtëshkollore.

Moduli është menduar të zhvillohet nga **mësuesi kujdestar** në kuadrin e orëve të kujdestarisë, roli i të cilit në këtë rast merr edhe një dimension të ri.

Moduli mund të zhvillohet edhe nga **psikologu i shkollës**.

Po kështu, veprimtari të veçanta të tij mund të zhvillohen dhe nga **mësues të lëndëve të ndryshme**, në kuadrin e mësimdhënies së tyre, kur përmbajtja mësimore e mundëson këtë trajtim. Mundësi të tilla ekzistojnë në të gjitha lëndët. Vetë lënda përmban mundësinë që përmbajtja e saj të lexohet në këndvështrimin e fushës së zbatimit, të vlerës që ofron kjo fushë për shoqërinë, e mundësive për punësim si dhe në këndvështrimin e njohurive dhe të aftësive të nevojshme për të qenë në lartësinë e pritshmërive të shoqërisë e të ekonomisë. Në këtë këndvështrim, përmbajtja e lëndës lidhet me realitetin, me mjediset e punës, me nevojat e dëshirat e nxënësve etj.

Moduli i plotë ose veprimtari të veçanta të tij mund të zhvillohen në mjedise të ndryshme mësimore ose në shkollat qendra komunitare, nga të ftuar të tillë, si: **sipërmarrës, prindër** ose **punonjës të bashkive ose të minibashkive**, të cilët gjithnjë e më shumë po shtojnë në misionin e tyre, edhe informimin e publikut për botën e punës dhe të mundësive të saj.

Veprimtaritë e veçanta janë parashikuar të zhvillohen brenda 45 minutave, gjatë të cilave drejtuesi dialogon me nxënësit. Ai i fton ata në një proces reflektimi të pavarur individual, rezultatet e të cilit i fiksojnë në fletët e tyre të punës. Është mirë që drejtuesi i veprimtarive (p.sh.: psikologu, mësuesi etj.) të ketë fotokopjuar fletët e punës për të gjithë nxënësit.

Me lejen e nxënësve, fletët e plotësuara mund të vendosen në një vend të dukshëm në klasë dhe në vijim, idetë e shprehura në to mund të bëhen objekt diskutimi në klasë. Që në fillim, mësuesi u bën të qartë nxënësve se ata do të ndajnë idetë dhe reflektimet e tyre me njëri-tjetrin.

Në fund të veprimtarisë, organizuesi i saj bën **përmbledhjen** e ideve kryesore të modulit dhe të atyre të shprehura nga nxënësit. Në këtë përmbledhje, ai mban parasysh objektivat e veprimtarisë dhe kuadrin e përgjithshëm të zhvillimit të saj - **edukimin për karrierën**.

Të mos harrojmë! Veprimtaritë e kësaj faze nuk synojnë të ndihmojnë nxënësit të zgjedhin karrierën, por t'i ndihmojnë ata të kuptojnë ndërlidhjen e gjithë çka bëjmë në jetë dhe të krijojnë e të ushtrojnë modelin e vendimmarrjes së mirëmenduar dhe të vendimmarrjes së orientuar nga e ardhmja. Në këtë këndvështrim, ky modul do t'i ndihmojë nxënësit të mendojnë e të planifikojnë seriozisht për të ardhmen e tyre, duke shpresuar që zgjedhjet që bëjnë të jenë në interesin e tyre.

PJESA E PARË

Të dashur nxënës!

Kur ju morët vendimin për të vazhduar shkollën e mesme, veçanërisht gjimnazin, keni marrë edhe një vendim tjetër: atë të vazhdimit të studimeve në arsimin e lartë apo të ndjekjes së një programi profesional mbas shkollës së mesme, gjë që ju hap rrugën për të punuar në fusha e profesione të ndryshme. Vetëm arsimi i mesëm i përgjithshëm nuk ju lidh paraprakisht me një profesion.

Sigurisht, ju keni menduar për të ardhmen tuaj edhe në arsimin bazë dhe, në një farë mënyre, ju e keni bërë një zgjedhje: atë të vazhdimit të arsimit të mesëm të përgjithshëm ose të arsimit profesional. Ata që kanë zgjedhur arsimin profesional, i kanë pasur më të qarta dëshirat për profesionin e tyre dhe, vetë ose me ndihmën e prindërve, e kanë marrë një vendim në drejtim të zgjedhjes edhe të profesionit.

Të marrësh një vendim për profesionin e ardhshëm, nuk është e lehtë. Në mënyrë të veçantë, juve ju kërkohet ta merrni këtë vendim në një moshë të re, kur nuk njihni sa duhet as veten dhe mundësitë tuaja, dhe as botën e punës dhe të profesioneve. Të vetmen gjë që dini me siguri, është fjala e përsëritur e prindërve që, nëse dëshironi të realizoni ëndrrat tuaja, duhet të mësoni gjatë gjithë kohës dhe në të gjitha lëndët.

Sot është koha për të menduar seriozisht për të ardhmen tuaj, për profesionin tuaj, për atë që dëshironi të bëheni dhe të bëni në jetë.

Për këtë qëllim ju ftojmë të njiheni me disa situata reale, në të cilat janë ndodhur nxënës të ndryshëm maturantë, të cilët duhet të zgjedhin lëndën e provimit me zgjedhje në provimet e maturës shtetërore.

Në këto situata ndodhen një pjesë e madhe e maturantëve. Shumë shpejt edhe ju do ta shihni veten në situata të ngjashme me dilema e sfida të vendimmarrjes. Është mirë që t'i njihni tani për të qenë të përgatitur.

VEPRIMTARI



Fokus

Këto veprimtari synojnë të ndërtojë nxënësit, që fillojnë studimet në gjimnaz për situatat, në të cilat do të gjenden dhe t'i nxitin ata të mendojnë që sot për të ardhmen e tyre të dëshiruar, për vendimet që duhet të marrin e zgjedhjet që duhet të bëjnë për të përgatitur këtë të ardhme, si dhe për gatishmërinë për të vënë në jetë vendimet e tyre.

Situatat me të cilat ata do të përballen, janë të larmishme. Secila prej tyre është rezultat i një sjelljeje të caktuar. Shumë prej tyre mund të jenë të vështira për t'u menaxhuar, prandaj është në interesin e nxënësve që t'i njohin ato që më parë. Në këtë mënyrë, ata do ta kenë më të lehtë të shmangin situatat e padëshiruara dhe të mundësojnë ato që i bëjnë vendimet e zgjedhjet e tyre për të ardhmen më të lehta.

Veprimtaritë e mëposhtme synojnë të ndihmojnë nxënësit të njihen me disa nga dilemat, me të cilat janë përballur shumë nxënës gjimnazistë e maturantë në vite.



Veprimtari 1



Fokus

Në provimet e maturës, përveç lëndëve të detyrueshme, nxënësit kanë të drejtë të zgjedhin një lëndë, që përveçse shpreh dëshirën e tyre për degën që do të studiojnë në arsimin e lartë, ndikon edhe në vlerësimin që i bëhet kësaj lënde në këtë degë. Po kështu, gjatë vitit të fundit të gjimnazit, shumë nxënës i përqendrojnë të tëra forcat në përvetësimin e kësaj lënde.

Një ndër problemet që shoqërojnë zgjedhje të tilla, është ngushtimi i mundësive për të zgjedhur një lëndë tjetër për provimin e maturës me zgjedhje, pasi nxënësit, në shumë raste, i shpërfillin lëndët e tjera dhe koha për t'u përgatitur për një lëndë tjetër është shumë e kufizuar.

Po kështu, nxënësit mund të vendosin të zgjedhin një lëndë tjetër për provimin e maturës me zgjedhje, e cila vlerësohet me koeficient të lartë edhe nga degë të tjera. Problemi është i njëjtë. Ata e kanë të vështirë të mësojnë këtë lëndë të re në prag të provimit të maturës, nëse nuk e kanë studiuar atë gjatë vitit (ose viteve të shkollimit).



Objektivat

Në fund të kësaj veprimtarie, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të tregojë disa nga pasojat e të mësuarit vetëm të një lënde ose një grupi të vogël lëndësh gjatë viteve të gjimnazit
- të tregojë disa nga pasojat e zgjedhjes për të mësuar vetëm në vitin e fundit të gjimnazit.
- të tregojë lidhjen që ekziston ndërmjet planifikimit të zgjedhjeve për të mësuar disa lëndë gjatë viteve të gjimnazit me mundësitë dhe lirinë për të zgjedhur degët, për të cilat dëshiron të studiojë.
- të tregojë lidhjen që ekziston ndërmjet planifikimit të zgjedhjeve për të mësuar disa lëndë gjatë viteve të gjimnazit me mundësitë dhe lirinë për të zgjedhur lëndët për provimin e maturës me zgjedhje.
- të reflektojë për rëndësinë e planifikimit të drejtë të studimit për qëllim karriere gjatë viteve të gjimnazit.

Materiale: Fletë pune nr. 1.

Zhvillimi i veprimtarisë

Hapi i parë

Mësuesi e ndan klasën në grupe dhe secilit grup i shpërndan *fletë pune nr. 1*.

Ai u kërkon nxënësve të reflektojnë për problemin, me të cilin po përballet Klea dhe vështirësinë, në të cilën ajo ndodhet, duke u bazuar në pyetjen e mëposhtme:

- ▶ Cili është problemi i Kleas? Pse ky është një problem?
- ▶ Pse Klea e ka të vështirë të marrë një vendim? Cilat mund të jenë disa nga arsyet që një vendimmarrje e tillë në këtë kohë nuk është gjithmonë e lehtë?

Grupet përgatitin me shkrim përgjigjet e tyre.

Hapi i dytë

Mësuesi kërkon nga grupet të paraqesin përgjigjet e tyre dhe, më pas, fton klasën në një proces diskutimi përmbledhës dhe reflektimi, duke u mbështetur në pyetjet e mëposhtme:

- Pse Klea ndodhet në një situatë të tillë?
- Pse ajo mendon që me lëndën e fizikës mund të ketë më shumë mundësi për pikë nga më shumë fakultete?
- A do ta ndryshonte Klea lëndën, nëse gjatë tri viteve të gjimnazit nuk do të kishte studiuar lëndën e fizikës?
- Çfarë do të ndodhë me një nxënës, që në fund të studimit i duhet të zgjedhë për provim një lëndë që ai nuk e ka studiuar?
- A mund të merren në fund të shkollimit vendime të tilla? Pse?
- Kur është nxënësi më i lirë, të bëjë zgjedhjet që dëshiron?
- Çfarë duhet bërë për këtë qëllim?

Veprimtari 1

Fletë pune 1

Këto ditë Klea, maturante, ka plotësuar formularin në të cilin ka përcaktuar lëndën për provimin me zgjedhje të maturës shtetërore. Ajo ka zgjedhur biologjinë, sepse është lëndë e rëndësishme edhe për ata që zgjedhin të vazhdojnë studimet në degën e mjekësisë.

Por Klea nuk është e sigurt, nëse ka bërë zgjedhjen e duhur, pasi ajo mendon që lënda e biologjisë nuk vlerësohet me koeficientin maksimal në degë të tjera të shkencave të natyrës ose të inxhinierisë. Ajo mendon që, po të zgjedhë lëndën e fizikës, do të zgjerojë numrin e degëve që e vlerësojnë notën e kësaj lënde me koeficient të lartë. Për këtë arsye, për të shtuar mundësitë e marrjes së pikëve të larta në më shumë degë, ajo vendos që të zgjedhë lëndën e fizikës për provimin me zgjedhje, krahas lëndëve të detyrueshme që janë gjuha shqipe dhe letërsia, matematika dhe gjuha e huaj e parë.

Megjithatë, Klea nuk e ka të lehtë të vendosë ... Ajo ...

- Cili është problemi i Kleas? Pse ky është një problem?
- Pse Klea e ka të vështirë të marrë një vendim? Cilat mund të jenë disa nga arsyet që një vendimarrje e tillë në këtë kohë nuk është gjithmonë e lehtë?



Fokus

Veprimtari 2

Kjo veprimtari synon t'i bëjë të vetëdijshëm gjimnazistët, për të kuptuar situatën që do të ndodhen në fund të shkollimit. Nëse ata nuk i kushtojnë rëndësinë e duhur studimit, kur duhet të zgjedhin për degën (për rrjedhojë edhe profesionin) për të cilën do të studiojnë (nëse nuk e kanë zgjedhur më parë) dhe për lëndët e provimit me zgjedhje, do të përballen me situata të padëshiruara.



Objektivat

Në fund të kësaj veprimtarie, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të tregojë disa nga sfidat me të cilat do të përballen vendimmarrja e Denit për jetën në fund të shkollimit.
- të tregojë disa nga pasojat që ka për secilin mungesa e studimit gjatë viteve të gjimnazit.
- të tregojë çfarë duhet të kishte bërë ndryshe Deni që në fillim të shkollës së mesme e deri në përfundim të saj.
- të reflektojë e të diskutojë për përgjegjësinë që ka secili ndaj vetes, familjes, shoqërisë.

Materiale: Fleta e punës nr. 2.

Zhvillimi i veprimtarisë

Hapi i parë

Mësuesi, pasi u kujton nxënësve rëndësinë e vendimmarrjeve të mençura e të bëra në kohën e duhur, u shpërndan fletën e punës nr. 2 dhe u kërkon të reflektojnë për disa minuta për situatën në të cilën ndodhet Deni, duke u bazuar edhe te pyetjet që ndodhen në këtë fletë.

Hapi i dytë

Mësuesi i fton nxënësit të ndajnë mendimet e tyre, ndërkohë që shënon në tabelë përmbledhjen e ideve. Më pas, ai kërkon prej tyre të shprehin qëndrimin në lidhje me përgjegjësinë që ata ndiejnë:

- për veten e të ardhmen e tyre,
- për familjen...,
- për shoqërinë...

Veprimtari 2

Fletë pune 2

Deni, nxënës maturant, duhet të vendosë për degën që dëshiron të studiojë dhe për rrjedhojë edhe për provimin me zgjedhje. I nxitur nga prindërit, ai njihet edhe me pikët që kërkohen për të fituar të drejtën e studimit në një nga degët që preferohen edhe në grupin e tij shoqëror. Këto pikë ishin të larta dhe mesatarja e notave të tij të gjimnazit ishte e pamjaftueshme për t'i arritur. Ai nuk kishte menduar më parë për këtë situatë, ndaj nuk kishte bërë asgjë për ta shmangur atë gjatë viteve të shkollimit në shkollën e mesme. Deni nuk kishte studiuar sa duhet dhe tani rrezikon të drejtën e studimit. Mundësitë për të ardhmen e tij, tani që e mendon, janë gjithnjë e më e paqarta. Ai ndihet në udhëkryq. Mbi të rëndon përgjegjësia, ndaj ...

Reflektoni

- Vendoseni veten në vendin e Denit. Shumë shpejt kjo mund të jetë situata juaj. Cilat janë disa nga problemet me të cilat ai po përballet?

- Cilat janë gjërat që duhet të bënte Deni, kur filloi studimet në shkollën e mesme?



Fokus

Veprimtari 3

Kjo veprimtari synon të ndërgjegjësojë nxënësit për rëndësinë që kanë shkencat shoqërore për studimin e shoqërisë, si një fushë studimi më e vështirë se natyra në thelbin e vet, por edhe për arsye të interesave të shumta që e pengojnë qëllimisht njohjen e shoqërisë, duke ngritur mure e perde të shumta. Ndërkohë, vendimet më të shumta në jetë e që ndikojnë fuqishëm jetën tonë, merren nga fusha e veprimtarisë shoqërore.

Janë pikërisht këto vështirësi që kërkojnë aftësi të mëdha intelektuale për njohjen e saj. Kjo do të thotë që shoqëria nuk duhet të njihet nga njerëzit “e prerë” për t’u marrë me të, por nga njerëz me aftësi të larta mendore. Ndërkohë, gjerësisht ende sundon ideja e nxënësve “të prerë” për njohjen e natyrës dhe “të prerë” për njohjen e shoqërisë.



Objektivat

Në fund të kësaj veprimtarie, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të diskutojë për rëndësinë që ka studimi i shoqërisë për vetë shoqërinë..
- të përshkruajë veten përtej kornizave që i kategorizojnë njerëzit “të prerë” për të bërë disa gjëra e për të mos bërë disa të tjera.
- të fillojë të njohë aftësitë e veta dhe të fitojë besimin te vetja..

Zhvillimi i veprimtarisë

Mësuesi lexon fletën e punës nr. 3 dhe fton klasën në një proces reflektimi ndaj problemeve e dilemave të Bledit, duke drejtuar pyetjet e mëposhtme:

Të reflektojmë së bashku

- Cila është dilema e Bledit? A është kjo edhe dilema juaj?
- A e shikoni veten “të prerë” për njërin apo tjetrën fushë?
- Cilat janë kriteret që i përcaktojnë nxënësit në këtë mënyrë?
- Cilat janë disa nga pasojat e ndarjes së nxënësve në këtë mënyrë?
- A janë njerëzit të lindur për një fushë apo kjo është rrjedhojë e zgjedhjeve dhe veprimeve të tyre që e kanë kufizuar veten, duke mos studiuar sa duhet?
- A janë disa njerëz më inteligjentë se të tjerët e disa më pak, apo kjo ka shpjegim tjetër?
- A meriton shoqëria të studiohet nga njerëz të aftë profesionalisht?

Veprimtari 3

Fletë pune 3

Bledi, nxënës në klasën e njëmbëdhjetë të gjimnazit, i duhet të vendosë për lëndët që duhet të studiojë në klasën e dymbëdhjetë dhe, për këtë, duhet të zgjedhë nga lista e lëndëve të ndara në grupe:

a) grupi i lëndëve të shkencave të natyrës dhe **b) grupi i lëndëve të shkencave shoqërore.**

Bledi është i zoti në shkencat e natyrës dhe për këtë arsye, prindërit dhe miqtë i kanë sugjeruar të vazhdojë studimet në një nga degët e shkencave inxhinierike. Por Bledit i pëlqen të studiojë për shkencat shoqërore. Atë e tërheqin studimet sociologjike, analizat politike etj. Djalin e shqetëson presioni i familjes dhe sugjerimet e shkollës e të miqve se ai “është i prerë” për shkencat natyrore dhe i ka aftësitë për këto shkencat. Mirëpo, Bledi mendon ndryshe. Ai është kundër mitit që i sheh disa njerëz “të prerë” për shkencat natyrore dhe disa të tjerë “të prerë” për shkencat shoqërore.



Fokus

Veprimtari

4

Kjo veprimtari synon të ftojë nxënësit në një reflektim përmblledhës për rolin e shkollës në formimin e nxënësve dhe përgjegjësinë e nxënësve ndaj vetes dhe ndaj përmirësimit të rolit të shkollës në funksion të qëllimit të saj.



Objektivat

Në fund të kësaj veprimtarie, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të reflektojë për rolin e shkollës në formimin e nxënësve dhe për orientimin e tyre për të ardhmen.
- të shprehë qëndrimin e tij në lidhje me këtë rol.
- të sugjerojë përmirësime të mundshme në drejtim të misionit të shkollës dhe të punës së saj në përgatitjen e nxënësve për jetë dhe punë.
- të shprehë përkushtimin e tij ndaj të mësuarit të vazhdueshëm e të gjithanshëm.

Materiale: Fletë pune nr. 4

Zhvillimi i veprimtarisë

Mësuesi u lexon nxënësve pjesën e shkëputur nga eseja e një nxënësi me titull “Orientimi për të ardhmen” dhe fton nxënësit të reflektojnë e të diskutojnë, duke shprehur qëndrimin e tyre për çështjet e mëposhtme:

SHKOLLA DHE NE

1. Shkolla për ne

Nuk janë të pakta rastet kur sistemet shkollore kritikohen, sepse nuk i shërbejnë përgatitjes së nxënësve për jetën. Mendimet për këtë janë të ndryshme.

- Cili është mendimi juaj në lidhje me këtë çështje? I shërben shkolla jonë jetës apo jo? Pse mendoni kështu?
- Cilët janë disa nga treguesit e një shkolle që i shërben përgatitjes suaj për jetën?
- A i ofron shkolla jonë mundësitë për të mësuar për jetën?
- Çfarë kërkon jeta? A i keni të qarta këto pritshmëri?

2. Ne për veten tonë

Nxënësit hyjnë në shkollë me një pikënisje të njëjtë. Por, në përfundim të saj, disa nxënës **ndihen më të lirë për të marrë vendime** për jetën e tyre, ndërsa të tjerë e kanë shumë të vështirë për ta bërë një gjë të tillë.

- Ç'do të thotë të jesh i lirë të marrësh një vendim?
- Kur e merr njeriu lehtësisht dhe lirisht një vendim për jetën?
- Një filozof thotë që “liria është domosdoshmëria e njohur”. Si duhet ta kuptojmë një thënie të tillë?

Shkolla duhet të ofrojë mundësi të barabarta për të gjithë nxënësit që e ndjekin atë. Në përgjithësi shkolla e bën një gjë të tillë, por jo të gjithë nxënësit i shfrytëzojnë njëloj këto mundësi.

- Cilat janë mundësitë që ofron shkolla dhe cilat janë ato që ju duhet të shfrytëzoni, për të qenë të lirë të merrni vendimet për jetën tuaj të ardhme?
- Reflektoni për rrugëtimin tuaj në shkollë deri tani. A mendoni se i keni shfrytëzuar sa duhet mundësitë që ofron shkolla? A kanë qenë kërkesat e jetës suaj të ardhme udhërrëfyese i vazhdueshëm për ju, si dhe kriter për të gjykuar sa mirë ju po kryeni detyrën tuaj ndaj vetes?
- Çfarë do të bënit ndryshe?
- Çfarë do të bëni ndryshe?

Në fund të fundit, asnjëherë nuk është shpejt dhe asnjëherë nuk është vonë të mendoni më seriozisht për ëndrrat tuaja dhe t'i çoni ato në një nivel më të lartë, duke përfshirë në të jo vetëm profesionin që dëshironi, por edhe **planifikimin** e realizimit të kësaj ëndrre dhe shtrimin e themeleve për këtë qëllim. Sfidat janë të mëdha edhe për faktin se edhe zgjedhjet janë shumë të larmishme.

Veprimtari 4

Fletë pune 4

**Shkëputur nga testi i provimit të lëndës gjuhë shqipe dhe letërsi,
Matura shtetërore 2021**

ORIENTIMI PËR TË ARDHMEN

Fragment nga eseja e një gjimnazisti

Para se të hidhja hapat në korridoret e gjimnazit, bashkë me disa të rinj të tjerë, ndoqëm një numër takimesh informuese, që kishin për qëllim të na orientonin për mënyrën e organizimit të kohës në shkollë. Shumë nga mësimet që na u dhanë, kanë qenë mjaft të dobishme. Planifikimi është një ide tejet e mençur. Javët e para të një semestri vendosin se si do të shkojë pjesa tjetër e vitit. Përgatitja për një test është shumë më e frytshme, nëse shtrihet në kohë, në vend që të studiohet vetëm një natë përpara provimit. Unë jam shumë mirënjohës për këto mësimet.

Megjithatë, ka edhe diçka tjetër që unë do të kisha dashur të ma kishin mësuar: sa e rëndësishme është të mos zgjedhim një fushë që e kufizon zhvillimin e individit, qoftë ai në sferën akademike apo edhe jashtë saj. Në takimet e zhvilluara na këshilluan të përqendroheshim në studimin e një grupi lëndësh të veçanta, të cilat do të na ndihmonin të arrinim qëllimet tona finale. Është shumë e rëndësishme t'u kushtojmë vëmendje kërkesave për diplomim, por kjo vëmendje kaq e lartë krijon edhe pengesat e veta. Ajo u shkakton nxënësve aq shumë mundim për të planifikuar jetën e tyre pas përfundimit të shkollës, saqë çdo gjë në shkollë duket sikur është e mbërthyer pas saj. Ndoshta gjërat nuk janë kaq keq, por e vërteta është se nxënësit që do të ndjekin shkollën e lartë, priren, gjithashtu, të jenë të fiksuar pas idesë se çfarë do të bëjnë pas përfundimit të saj.

Por bota nuk mbetet gjithnjë në një vend, ajo ndryshon. Arsimimi duhet të jetë pjesë e jetës sonë edhe pas mbarimit të shkollës, si dhe duhet të jetë shumë më i gjerë nga sa e imagjinojmë. Leonardo da Vinçi shkëlqeu në një mori fushash. Si mjeshtri që krijoi “Mona Lizën”, Leonardo jo vetëm ishte piktori më i madh i të gjitha kohërave, por kontribuoi në fushën e matematikës, mjekësisë dhe inxhinierisë. Imagjini se çfarë do të kishte humbur bota, nëse ai do të ishte këshilluar të zgjidhte një fushë të caktuar dhe të përqendrohej vetëm në të. Da Vinçi ishte i madh, pasi ai nuk e kufizoi veten vetëm në një fushë të ngushtë studimi. Imagjinata e tij ishte e pakufi, ndaj ai nuk mund të kufizohej në një drejtim të vetëm. Unë mendoj se ata që zgjedhin të specializohen në një fushë të caktuar, nuk do të përfitonin nga ajo çfarë ekziston përtej kufijve të “fushave tona të studimit”.

Orientimi i vëmendjes së nxënësve drejt një fushe të caktuar bën që të ngushtohet vizioni i tyre. Nëse planifikojmë të shkojmë në fakultetin e shkencave, natyrshëm zgjedhim lëndët shkencore. Nëse planifikojmë të bëhemi artistë, padyshim orientohemi drejt arteve pamore. Por imagjini se çfarë mund të ndodhte nëse do ta ndryshonim pak vizionin tonë. Nuk ka asnjë artist, puna e të cilit nuk përmirësohet nga njohuritë shkencore dhe asnjë biolog, puna e të cilit do të dëmtohej nëse do të interesohej edhe për artin. Nxënësit e shkollës sonë duhet ta zgjerojnë horizontin e tyre dhe të bëhen pjesë e botës.

PJESA E DYTË

Të dashur nxënës,

Deri sot ju keni marrë shumë vendime për veten tuaj. Në fakt, ju merrni vendime nga mëngjesi në mbrëmje.

Vendimet i marrim për pasojat e tyre. Në disa raste vendimet që keni marrë, kanë qenë të mençura dhe pasojat kanë qenë ato që keni dëshiruar ose keni pritur.

Por, në raste të tjera, vendimet nuk kanë sjellë pasojat që keni pritur ose dëshiruar. Madje, këto pasoja mund të jenë shumë të këqija për ju. Kjo u ka ndodhur të gjithëve.

Kjo ndodh sepse, shpeshherë:

- nuk jemi të qartë për atë që dëshirojmë;
- nuk kemi qenë të informuar sa duhet për çështjen:
 - marrim vendim mbi bazën e idesë së parë që na vjen në mendje;
 - marrim vendim mbi bazën e përshtypjeve ose informacioneve të gabuara;
 - arsye të tjera;
- nuk kemi pasur të qartë lidhjen shkak-pasojë ndërmjet vendimit (veprimit tonë) dhe rezultatit që prisnim.

E gjithë jeta është një proces vendimmarrjeje. Çdo ditë është e mbushur me vendime, ndaj duhet të mësojmë si të marrim vendime jo vetëm për të shmangur gabimet dhe pasojat e padëshiruara, por për të arritur ato që dëshirojmë.

Vendimet lënë gjurmë në jetën tonë. Ne nuk mund t'i ndryshojmë, sepse ato do të na shoqërojnë gjatë gjithë jetës.

Ne duhet të krijojmë modelin tonë të vendimmarrjes si një aftësi për jetën.

Të marrim vendim për profesionin tonë të ardhshëm!

Një ndër çështjet më të rëndësishme, për të cilën marrim vendim, është ajo që lidhet me të ardhmen tonë, me punën që do të bëjmë për të plotësuar nevojat dhe dëshirat tona.

Pra, ne duhet të marrim vendim për profesionin që dëshirojmë.

Mos harroni!

- Çdo vendim që merrni, ka pasoja.
- Pasojat do t'ju shoqërojnë gjatë gjithë jetës.
- Çdo pasojë ndikon në hapat e mëtejshëm.

Duhet të mësojmë si të marrim vendime.

- Të krijojmë modelin tonë të vendimmarrjes.

Ndër të tjera, duhet t'u përgjigjemi grupeve të mëposhtme të pyetjeve:

GRUPI I PARË I PYETJEVE – Dëshirat

- Cili është profesioni që dëshiroj?
- Përse e dëshiroj këtë profesion?
- A di gjithçka për këtë profesion?
- Si kam mësuar për këtë profesion?
- A mund të mësoj më shumë për këtë profesion?
- Nga do të mësoj më shumë për këtë profesion?

GRUPI I DYTË I PYETJEVE – Familja - interesat-modelet

- Cili është profesioni që prindërit ose të afërmit dëshirojnë për mua?
- Përse prindërit ose të afërmit dëshirojnë këtë profesion?
- A e dëshiroj edhe unë këtë profesion?
- A kam unë një model në familjen time?
- _____?

GRUPI I TRETË I PYETJEVE – Dilemat

- Cili është profesioni që duhet të zgjedh?
- Përse duhet të zgjedh këtë profesion?
- Cilat janë njohuritë dhe aftësitë që kërkon ky profesion?
- A e realizoj dot dëshirën time? Pse mendoj kështu?
- A kam mësuar sa duhet për të mundësuar zgjedhjen time?
- Çfarë duhet të mësoj më shumë për të mundësuar realizimin e dëshirës sime?
- _____?

Veprimtari 5

Në kërkim të njohjes së profesioneve në vendin ku banoj

TË HYJMË NË BOTËN E PROFESIONEVE!



Fokus

Kjo veprimtari synon ta përfshijë nxënësin në botën e profesioneve, së pari, duke i ofruar atij disa grupime profesionale, të para në disa këndvështrime:

- sipas larmisë së profesioneve që ndodhen në komunitet;
- sipas mundësive të zgjedhjes në botën e larmishme të profesioneve;
- sipas lidhjes së profesioneve në grupime, të cilat kërkojnë edhe grupime njohurish dhe aftësish.

Kjo veprimtari kërkon edhe detyrën e përfshirjes së nxënësit në një proces kërkimor, të cilin ai mund ta kryejë edhe me ndihmën e të afërmeve.



Objektivat

Në fund të kësaj veprimtarie, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë disa nga profesionet që lidhen me biznese dhe shërbime të zakonshme në jetën e një komuniteti, të cilat përfshihen në fletën e tij të punës.
- të shpjegojë pse disa nga profesionet ose shërbimet duhet të shihen si të grupuara.
- të eksplorojë, vetë ose me ndihmën e të afërmeve, disa nga grupimet e profesioneve që ndodhen në komunitetin e tij.

Materiale: Fletë pune për t'u plotësuar në mënyrë individuale nga nxënësit.



Kohëzgjatja: 45 minuta.

Veprimtari 5

Fletë pune 5

Të njihemi me disa nga profesionet brenda grupimeve të ndryshme

Ndërtim	Shërbimet Mjedisore	Puna me kafshët
Mundësi profesionalesh:	Mundësi profesionalesh:	Mundësi profesionalesh:
<ul style="list-style-type: none"> • Ndërtues • Karpentier • Elektracist • Vlerësues pronash • Kopshtar • Drejtues punimesh • Murator • Bojaxhi • Përgjegjës kantieri • Hidraulik • Instalues sistemesh sigurie/ alarme zjarri • Shtrues pllakash mermeri 	<ul style="list-style-type: none"> • Menaxher për sigurimin e përputhshmërisë mjedisore • Studiues • Teknik i kampionimit Mjedisor • Specialist largimi materialesh të rrezikshme • Punonjës për shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës • Teknik kontrolli/ parandalimi ndotjeje • Teknik i mbetjeve të ngurta • Toksikolog • Menaxher i mjedisit ujor • Menaxher i cilësisë së ujit 	<ul style="list-style-type: none"> • Kujdestar kafshësh • Ushqyes kafshësh • Studiues kafshësh • Prodhues qumështi • Teknik transferimi embrionesh • Specialist i operacioneve ushqyese • Gjenetist i kafshëve • Drejtues dyqani kafshësh • Fiziolog riprodhimi • Veteriner • Ndihmës veteriner
Arte pamore	Gazetari dhe Transmetime	Shërbimet Terapeutike
Mundësi profesionalesh:	Mundësi profesionalesh:	Mundësi profesionalesh:
<ul style="list-style-type: none"> • Drejtues Artistik • Artist • Projektues • Stilist • Projektues grafik • Projektues i mjediseve të brendshme • Tregtues i artit pamor 	<ul style="list-style-type: none"> • Folës • Teknik i pajisjeve audio dhe video • Teknik transmetimi • Redaktor • Analist/reporter/ Korrespondent Lajmesh • Operator radioje • Teknik i inxhinierisë së Zërit • Shkrimtar 	<ul style="list-style-type: none"> • Trajner atletik • Fizioterapist • Dentist • Dietolog • Ndihmës i shëndetit në shtëpi • Mjek • Ndihmësmjek • Infermier i licencuar

Të zbulojmë grupimet e profesioneve që na interesojnë

A large rectangular area with a red dashed border, containing horizontal green dashed lines for writing. This area is intended for students to list professional groups that interest them.

Veprimtari 6

MES DILEMAVE TË VENDIMMARRJES

Profesioni që dëshiroj dhe profesioni që zgjedh



Fokus

Shpesh njerëzit nuk zgjedhin profesionin që dëshirojnë ose kanë dëshiruar të bëjnë, sepse:

1. Profesioni që një njeri dëshiron:

- nuk ofron shumë mundësi punësimi;
- nuk bën pjesë në profesionet me mundësi zhvillimi;
- nuk ofron pagë të mirë;
- prindërit sugjerojnë profesione të tjera;
- _____

2. Profesioni që një njeri dëshiron, kërkon njohuri dhe aftësi të caktuara, të cilat fitohen duke studiuar gjatë gjithë shkollimit.



Objektivat

Në fund të kësaj veprimtarie, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të flasë për profesionet që dëshiron për të ardhmen.
- të shpjegojë pse njerëzit mund të mos zgjedhin profesionin që dëshirojnë.
- të identifikojë disa nga faktorët që ndikojnë në vendimmarrjet e njerëzve për karrierën e tyre.
- të tregojë si mund të trajtojë pengesat që lidhen me realizimin e dëshirave të tyre në fushën e karrierës.

Materiale: Fletë pune për t'u plotësuar në mënyrë individuale nga nxënësit.



Kohëzgjatja: 45-90 minuta.

Fletë pune 6.1

A janë ëndrrat e mia edhe zgjedhjet e mia?

Plotësoni:

1. Profesioni ose grupimi i profesioneve që unë dëshiroj është _____

Por, unë mendoj se nuk mund të zgjedh profesionin që dëshiroj, sepse:	Shëno	Burimi i informacionit
• nuk ofron shumë mundësi punësimi;		
• nuk bën pjesë në profesionet me mundësi zhvillimi;		
• nuk ofron pagë të mirë;		
• kërkon njohuri dhe aftësi të caktuara, të cilat nuk mendoj se mund t'i zotëroj;		Unë vetë, mësuesi im, prindi im

2. Për të zgjedhur profesionin që dëshiroj, duhet:

- a. _____
- b. _____
- c. _____

Fletë pune 6.2

Rruga e bllokuar?

⇒ Çfarë më pengon të përmbush ëndrrat e mia?

Handwriting practice area with 6 horizontal dashed lines.

⇒ Konkretisht çfarë më pengon?

Handwriting practice area with 6 horizontal dashed lines.

⇒ Çfarë më pengon tani?

Handwriting practice area with 6 horizontal dashed lines.

⇒ Si mund ta zgjidh problemin tim?

Handwriting practice area with 6 horizontal dashed lines.

⇒ Kush mund të më ndihmojë?

Handwriting practice area with 6 horizontal dashed lines.

⇒ Kush beson në aftësitë e mia?

Handwriting practice area with 6 horizontal dashed lines.

A besoj në prirjet dhe aftësitë e mia? _____

Fletë pune 6.3

Aftësitë e mia

Blank writing area with horizontal dashed lines for text entry.

A mund të përmirësohem?

Blank writing area with horizontal dashed lines for text entry.

ANGAZHIMI IM

Cilat janë disa nga aftësitë që duhet t'i zotëroj më mirë?

A large rectangular area with a dashed red border, containing 25 horizontal dashed lines for writing.

Veprimtari 7

TË MËSOJMË MË SHUMË PËR PROFESIONET



Fokus

Në çdo hap të jetës do të na duhet të dimë më shumë për diçka, të kërkojmë informacion të ri ose plotësues. Por duhet të dimë të kërkojmë dhe ku të kërkojmë. Kjo veprimtari synon të përfshijë nxënësin në një proces kërkimi, i cili jo vetëm do ta pajisë atë me informacionin që dëshiron, por edhe me metodologjinë e kërkimit. Kjo metodologji, e përsëritur, do të krijojë edhe modelin e kërkimit si një aftësi për jetën.



Objektivat

Në fund të kësaj veprimtarie, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë elementet që lidhen me informacionin e plotë për një profesion.
- të dallojë informacionet për profesionin ose grupet e profesioneve që lidhen me interesat e tij.
- të dallojë fushat ose çështjet, për të cilat ky informacion nuk është i plotë.
- të përshkruajë disa nga burimet e informacionit për profesionet në përgjithësi ose për profesionin a grupimet e profesioneve me interes për të.

Materiale

Fletë pune për t'u plotësuar në mënyrë individuale nga nxënësit.
Libri i nxënësit, lëndë të ndryshme.



Kohëzgjatja: 2 x 45 minuta.

Veprimtari 7

Fletë pune 7.1

Të mësojmë më shumë për profesionet

1. Cili është profesioni, për të cilin dëshiron të dish më shumë dhe të hulumtosh më tej?

Blank writing area for question 1, featuring horizontal dashed lines.

2. Në cilin grup profesionesh bën pjesë profesioni që ke zgjedhur për të studiuar?

Blank writing area for question 2, featuring horizontal dashed lines.

Plotëso informacionin për profesionin që të intereson:

- Paga më e ulët _____ paga më e lartë _____
- Arsimimi i nevojshëm _____
- Një profesion që lidhet me të _____

3. Përshkruaj profesionin.

4. Shkruaj detyrat dhe përgjegjësitë e profesionit.

Veprimtari

7

Fletë pune 7.2

Profesioni, aftësitë, shkolla

1. Çfarë më pëlqen te profesioni i...?

2. Çfarë nuk më pëlqen te profesioni i...?

3. Aftësitë që mendon se janë të nevojshme për këtë profesion:

- Aftësi të të lexuarit dhe të shkruarit në gjuhën amtare
- Aftësi të kryerjes së veprimeve matematikore
- Aftësi për të punuar me makineri
- Aftësi për të drejtuar makineri komplekse
- Aftësi për të punuar vetëm, në mënyrë të pavarur
- Aftësia për të qenë krijues
- Aftësi kompjuterike
- Aftësi të të lexuarit dhe të të shkruarit në gjuhë të huaj
- Aftësi për respektimin e rregullave / disiplinës së punës
- Punë me njerëz
- Punë me kafshë
- Punë në mjedise të hapura
- Punë në mjedise të mbyllura
-
-
-

4. Unë mendoj se do të jem i mirë në këtë profesion, sepse ...

5. A e di çfarë duhet për këtë profesion? A e di se ku duhet të kërkosh informacion më të plotë për këtë profesion ose për profesione të tjera?

a. Nga lëndët në shkollë

Cilat lëndët janë të rëndësishme për këtë profesion?

- -----
- -----
- -----
- -----

Çfarë mund të mësosh/të zbulosh nga përmbajtja e lëndës në lidhje me fushën e zbatimit të njohurive që jep lënda?

- -----
- -----
- -----
- -----
- -----
- -----
- -----
- -----
- -----
- -----
- -----
- -----
- -----
- -----

Plotësoni tabelën e mëposhtme.

Lënda	Në çfarë veprimtarie mund të shërbejnë njohuritë e kësaj lënde?	Cilat janë profesionet e mundshme?
Kimia		
Fizika		
Arti		
Qytetaria		
Biologjia		
TIK		

b. Nga mësuesit tanë mund të mësojmë:

c. Nga prindërit dhe të afërmit mund të mësojmë:

Veprimtari 8

PUSHTETI VENDOR DHE INSTITUCIONET SHTETËRORE SI BURIM I VEÇANTË INFORMACIONI



Fokus

Pushteti vendor, si bashkia dhe institucione të tjera shtetërore, gjithnjë e më shumë, po përfshihen në veprimtari që lidhen me informimin e publikut për botën e punës dhe të profesioneve. Po kështu, ato po bëhen një faktor i rëndësishëm edhe në fushën e arsimit. Për këtë arsye, bashkia dhe këto institucione duhet të jenë dhe të përdoren nga sistemi arsimor jo vetëm si një aktor i rëndësishëm në fushën e arsimit, por edhe si një burim informacioni në fushën e edukimit dhe këshillimit për karrierën.



Objektivat

Në fund të kësaj veprimtarie, nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të identifikojë çështjet dhe fushat për të cilat bashkia mund të ofrojë informacion.
- të përshkruajë rrugën që duhet të ndiqet për të marrë informacionin e duhur nga bashkia.
- të sigurojë informacion për profesione të ndryshme dhe t'i ndajë ato me të tjerët.

Materiale: Fletë pune për t'u plotësuar në mënyrë individuale nga nxënësit.



Kohëzgjatja: *Eksplorim i pavarur:* një javë (burime online ose vizitë në institucion).
Ndarje informacioni: 45 minuta.

Veprimtari 8

Fletë pune 8

Çfarë mund të mësojmë nga bashkia?

Bashkia është përgjegjëse për shumë veprimtari që janë në shërbim të publikut. Këto janë në formën e biznesit ose të shërbimeve.

Eksploroni cilat janë bizneset dhe profesionet, për të cilat bashkia mund të ofrojë informacion.

	Bizneset	Profesionet
Si mund ta siguroj informacionin nga bashkia?		
	Shërbimet	Profesionet

Çfarë mund të mësojmë nga zyrat e punës?

Ato ofrojnë informacion për:

- tregun e punës;
- profesionet më të kërkuara;
- vendet e lira të punës;
- aftësitë që kërkohen për secilin profesion.

Eksploroni këtë burim informacioni për profesionet që ju interesojnë.

Kërkoni burime të tjera informacioni, sepse vendimi që do të merrni, ka për të qenë më i mençur, angazhimi juaj ka për të qenë i suksesshëm dhe rrugëtimi drejt tij ka për të qenë më i lehtë.

Si mund ta siguroj informacionin nga zyra e punës?	Bizneset	Profesionet
	Shërbimet	Profesionet



BASHKIA TIRANË ZYRA E KËSHILLIMIT TË KARRIERËS

Zyra e këshillimit të karrierës së bashkisë ofron informacione për profesionet, tregun e punës, ofertën arsimore, mundësitë e trajnimit, si dhe zotëron mjetet për shërbimin e këshillimit të karrierës.

Vizitoni faqen zyrtare me poshtë për të gjetur informacionin dhe shërbimin që ju nevojitet!

www.karriera.tirana.al

Zyra është e hapur çdo ditë, nga e hëna në të premten, 08:00 - 16:00.

Email: karriera@tirana.al

Tel: 0800 0888

Adresa: Rruga e Elbasanit, Parku “7 xhuxhat”, Tiranë

AKPA Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive

Në tërësinë e shërbimeve të AKPA-s përfshihen shërbimet e punësimit dhe administrimi i sistemit publik të arsimit dhe formimit profesional. Agjencia mbledh informacion edhe për ofruesit privat të formimit dhe është përgjegjëse për licencimin e tyre. Agjencia është e pranishme në të gjithë Shqipërinë nëpërmjet zyrave vendore të punësimit, drejtorive rajonale të formimit profesional publik dhe shkollave të arsimit profesional publik.

Portali Kombëtar i Punësimit është platforma, në të cilën ju mund të gjeni informacione për kualifikime profesionale, për vende të lira pune dhe hapësira ku mund të krijoni profilin tuaj si punëkërkes.

www.puna.gov.al

Zyrat e Punës së Shqipërisë

Tel: +35544538827

Email: kontakt@akpa.gov.al

Hënë - Enjte: 08:00-16:30 / Premte: 08:00-14:00